

## Sfida poetike

Rudolf Marku

Tani, në klimën e demokracisë, shkrimtarët do ta kenë shumë herë më të lehtë... Kështu mendojnë pak a shumë njerëzit - dashamirës, të cilët kujtojnë jo pa rënqethje atë perden e hekurt me të cilën përpigje ta izolonte shkrimtarin shteti totalitar. E megjithatë, vetë shkrimtarët nuk i beojnë krejt mendimit se demokracia politike, liria e të shprehurit, lehtësia e të botuarit vendos lehtësisht në fatin e letërsisë, po a shtu siç nuk besonin se diktatura do ishte në gjendje të ndryshonte ligjet e artit... Bile, duket se shkrimtarët prej shekujsh janë të vetëdijshëm për të kundërtën: Duhej të ekzistonte Ferri, që të mund të shkruhej vepra më e mirë e Dantes! Në një intervistë të bërë pak para vdekjes, Horhe Luis Borhes tha se ai gjithmonë e kish ditur se e keqja: vuajtjet, stërmundimet, zhgënjimet, do t'i ktheheshin në poezi, sepse lumturia nuk ka nevojë të kthehet në gjësend tjetër, sepse lumturia i mjafton vetvetes. Në kushtet e diktaturës, poezia shqipe, njëra ndër poezitë më të vjetra të kontinentit, provoi të mbijetonte, falë zgjuarsisë së saj, rebelizmit fisnik, elokuencës jotribunale, njeridashjes plot dhëmbshuri, intuitës së pagabueshme për të qenë moderne. Kjo është dhe arsyeja përse poezia shqipe shihej me sy të keq nga pushtetmbajtësit partiakë, përse anatemohej nëpër Plenum (veçanërisht në Plenumin e Katërt), përse shahej nga kritikët, nga publicistët banalë, nga estetët mediokër, nga shkrimtarët e presidiumeve etatiste. Njëri nga autorët e përfshirë këtu,

Adem Istrefi

### Drra që vjen

S'vjen për ata që s'kanë ç'presin prej saj  
për ata të tepërtit e lindur  
pa ditur pse kanë ardhur në këtë botë e  
veç varre shtojnë e  
asgjë më... ikin sikur të mos ishin,  
Jo, dita që vjen, s'vjen për të liqtë,  
as për ata që e therën në fyt ditën e sotme  
në syrin e majtë e në syrin e djathtë  
që të mos e shihte në udhë kah të vinte  
ditën që do të vinte,  
as për ata që pak ose aspak ngjajnë me njerëz:  
të pangjyrët, të pështirët, humbëfirët...  
(Ç'kërcënime mbytyjeje e përmytyjeje  
me zjarr Hiroshime  
lëshokan mbi ju, o popuj, o botë me krye në gisht!)  
Po s'vjen dhe s'vjen kjo ditë për ta.  
Dita që vjen e ndez cigaren në sytë e poetëve  
dhe niset për udhë me njëriun e udhës,  
udhës lajmëtare të mbarë njerëzimit,  
pa zot mbi krye, me zotra të shkelur ndër këmbë  
duke i bërë zë ditës tjetër të vijë sa më shpejt,  
të vijë dhe të vijë,  
siç i bën zë gruaja shtatzënë gjallesës së vet  
të vijë dhe të vijë...  
Dhe rroftë dita që vjen!...

1987

Prec Zogaj

### Gazmore për 1 prillin

Është një ditë e bukur sot në Tiranë.  
Vajzat thonë «po» - të e vonuara dhe qeshin,  
djemtë zemërohen e thonë: S'u duam!  
S'ka asnjë çudi që shatërvanët të nxjerrin livando,  
normalisht një shef përqafohet me vartësin,

më i riu nga të gjithë, për poezinë që po i ribotojmë, u thirr në Dëgën e Brendshme të Shkodrës dhe u kërcënuar me zhdukje fizike. Poeti i ri njëzet vjeçar u detyruar të kapërcejë kufirin, edhe pse kjo gjë aso kohe mund të paguhej me kokë. Është vetëm njëri ndër shembujt që dëshmon se poezia e botuar kalonte kalvarin e vet. Qëllonte që vëllimet poetike të analizoheshin në komitete Partie, në zyra sekrete të Ministrisë së Brendshme, në Komitetin Qëndror. Për poezinë flitej me përbuzje, asaj i liheshin të gjitha mëkatet, madje edhe prapambetja e kinematografisë e muzikës, e arkeologjisë, e shkencës meteorologjike, shpjegoheshin ngaqë poezia ishte prozaike, sepse ajo nuk kërcente sipas ritmit jambiko-dorik të profesorëve të metrikës, se e humbet mendjen mbas metaforave, atëherë kur duhej t'i kushtonte vëmendje direkte realitetit të mrekullueshëm socialist. Shumë poetë dhe u dënuan, u bënë karton dhe vëllime poetike, por para së gjithash, vrasjet bëheshin brenda librave të botuar, me heqje vargësh, strofash, poezish, duke urdhëruar autorët që t'i zëvendësonin me poezi që nxirreshin të gatshme nga sirtarët redaktorialë. Ky ishte ferri i poezisë së botuar, një poezi vërtet e paktë në numër, por gjithsesi e gatshme t'i kundërvihej Goliathit totalitar. Një poezi e kyçur nëpër dorëshkrim, por e shpallur në mesin e ditës, një poezi kokëforte, sfidante, kapriçoze, e vetërrezikuar që shkapërcente muret e komplotit të heshtjes së qeveritarëve e të falsifikatorëve akademikë.

Nxjerr t'i japë një cigare, e pyet: A keni ndonjë hall?  
Dhe falet prej tij për pyetjen e kotë.  
Është mes nesh seriozi që thotë gjithnjë të vërtetën.  
Përse nuk gënjen?-i themi me shaka.  
Seriozi vë buzën në gaz. Kaq mjafton,  
edhe ai është tani më 1 prill.

S'më bëhet të vete në shtëpi,  
humori i hollë i gruas më pret,  
dua të më «gënjejnë» fëmijët përsëri,  
t'i besoj fëmijët t'i kënaq fëmijët  
gjoja pa kuptuar ç'po ndodh në këtë botë,  
1986

Ndoc Gjetja

### Metamorfozë

Në fillim të karrierës e ndiente dhe vetë  
se fytyra (që dikur ia puthte nëna)  
nga dita në ditë po i bëhej e pavlefshme në jetë  
se në bisedat politike e hidhte brënda.

Prandaj një ditë në thellësi të vetes  
e mbyti njeriun.. (Jo me dhënie helmi.)  
me maskat që vinte njëherë pas tjetrës  
sipas nevojave që kishte shteti.

Kështu, ai, pak e nga pak  
nga njeri u bë diplomat.

1985

Natasha Lako

### Jetëgrabitësi

Në fillim ata thanë thjesht,  
merr nga jeta jote atë që na duhet më tepër,  
të kemi bërë nder, nga ana jote kemi hedhur zemrën që ke,  
të gjithë të tjerat, sa shihen, sa s'shihen janë për ne.

Ke për të gëzuar sytë e tu, lëkurën,  
ne po ta japim gjithçka siç e sheh,  
të kemi bërë nder, të kemi quajtur njeri,  
të gjitha të tjerat, sa shihen, sa s'shihen janë për ne.

Në qoftë se ti diçka tjetër kërkon  
edhe ne të tjerët do të kërkojmë më.  
Mbi këtë tokë të zezë, nën këtë qiell monoton,  
të gjitha sa shihen, sa s'shihen janë për ne.

Atëherë fare mirë mund t'ju marrim dhe kokën  
si bënte dikur çdo sundimtar mbi dhe,  
s'është gjë tjetër veç një parë e vogël  
dhe të gjitha këto, gjithë të tjerat janë për ne.

E në qoftë se kërkoni përsëri pak më tepër,  
fjala vjen, drejtësi a një fjalë të re  
të drejtë ne kemi t'ua marrim lëkurën dhe zemrën  
se të gjitha sa shihen, sa s'shihen janë për ne.

Pastaj për të pastruar ndërgjegjen tonë të vvarë,  
do të dalim të mbajmë një himn jete fjalim,  
e kush do ta dëgjojë atë që ne thamë,  
të gjitha të tjerat, të gjitha të tjera janë për ne.  
1988

Gjekë Marinaj

### Kuajt

Tërë jetën duke vrapuar rrimë,  
Shohim veç përpara  
ç'bëhet prapa s'duam t'ia dimë,  
Ne nuk kemi emër  
Të gjithëve kuaj na thonë,  
Nuk qajmë,  
Nuk qeshim,  
Heshtim,  
Dëgjojmë,  
Hamë atë ç'na japim,  
Ecim dhe na thonë,  
Asnjë nga ne s'është mendjehollë  
Kush qe kalë mbreti,  
Posti qe i lartë,  
Kush qe kalë princeshe,  
I bënë shalë të artë,  
Kush qe kalë fshatari  
Pat samarë me kashtë,  
Kush qe kalë i egër  
Tërë jetën fieti jashtë

Por qemë dhe mbetëm kuaj.

1990